

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|----------------------------------|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Filologjisë |
| Titulli i lëndës: | Psikolinguistikë II – Të nxënit e gjuhës |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | E obligueshme |
| Viti i studimeve: | IV/ Semestri VII |
| Numri i orëve në javë: | 2+1 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 7 |
| Koha / lokacioni: | E martë, 12.00-13.30, 75 |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. Asc. Dr. Rrahman Pacarizi |
| Detajet kontaktuese: | rrahman.pacarizi@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | <p>Psikolinguistika është studimi i gjuhës së individit në kuptimi të proceseve që ndodhin në trurin e njeriut gjatë përdorimit të gjuhës. Kështu Psikolinguistika ndahet në katër disiplina kryesore: Prodhimi i gjuhës, Të kuptuarit e gjuhës, Të nxënit e gjuhës dhe Çrregullimet gjuhësore. Meqë lënda e Psikolinguistikës mbahet në dy semestra, në semestrin e dytë fokusi në do të jetë te të nxënit e gjuhës, me theks të veçantë te të nxënit e gjuhës së pare, por do të trajtohet edhe të nxënit e gjuhës së dytë. Gjatë trajtimit të materies së lëndës do të mbështetemi te teoritë gjenerativiste, ato nativiste, bihejvioriste dhe kognitive.</p> |

| | |
|---------------------------|--|
| Qëllimet e lëndës: | <p>Qëllimi i kursit është që t'ua bëjë të ditura studentëve të Gjuhës Shqipe konceptet themelore të Psikolinguistikës si disiplinë relativisht e re shkencore e gjuhësisë dhe t'i njohë ata me nëndisiplinat themelore të saj, me lidhjet e saj me disiplinat e tjera të gjuhësisë dhe me shkencat të veçanta, si psikologjia, patologjia e të folurit etj. Kursi ka për qëllim që studentëve të ofrojë informacionin e mjaftueshëm për mundësinë e aplikimit të njohurive nga psikolinguistika në fusha praktike, si të mësuarit e gjuhës së parë, të nxënit e standardit dhe të mësuarit e gjuhës së dytë. Po ashtu, kursi synon t'i fusë studentët në studime më të thelluara të psikolinguistikës si një shkencë e cila deri më tash nuk është mësuar te ne, por edhe në</p> |
|---------------------------|--|

| | |
|---|--|
| | studime të tjera të gjuhësisë kognitive. |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Në fund të këtij kursi studentët do të jenë të zotët t'i dallojnë, identifikojnë, shpjegojnë dhe aplikojnë konceptet themelore të psikolinguistikës si shkencë. Studentët janë të aftë të organizojnë anketa psikolinguistike, janë në gjendje të monitorojnë procesin e të nxënit të gjuhës. Studentët në fund të kursit po ashtu aftësohen për t'u hyrë studimeve në disiplina të veçanta të psikolinguistikës dhe për ta aplikuar këtë njohuri praktikisht, sidomos në institucione parashkollore, por edhe te fëmijët me pengesa në të nxënit e gjuhës.</p> |

Kontributi në ngarkesën e studentit

| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
|-------------------------------|--------|-----------|----------|
| Ligjërata | 2 | 15 | 22.5 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 11.25 |
| Punë praktike/ konsultimet | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/ | 10 min | 15 | 2.5 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiime, seminare | 10 | 2 | 20 |
| Detyra të shtëpisë | 3 | 15 | 45 |

| | | | |
|--|--|----|------------------------------------|
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 | 15 | 45 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 10 | 3 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 2 | 2 | 4 |
| Projektet, Prezantimet ,etj | 45 min | 2 | 1.5 |
| Totali | | | 181.75:25 = 7.27 7 ECTS |
| Metodologjia e mësimdhënies: | | | |
| | Metodologjia e mësimdhënies është kryesisht e bazuar në ligjërata dhe në monitorimin e punimeve të pavarura të studentëve. Për shkak të mungesës së literaturës në shqip, mësimdhënësi ka përkthyer numër të madh artikujsh e kapitujsh nga librat më reprezentativë mbi psikolinguistikën. Mësimdhënësi orienton studentët lidhur me literaturën dhe monitoron unin e tyre, në kuptim të aplikimit të dijeve të fituara në ligjërata. | | |
| Metodat e vlerësimit: | | | |
| | Vlerësimi do të bëhet përmes monitorimit të angazhimit (10 pikë), përmes testit semestral (40 pikë) dhe testit final (50 pikë). Në vlerësim hyjnë edhe seminarët hulumtuese, të cilat vlerësohen me maksimalisht 20 pikë që alternohen me testin final. | | |
| Literatura | | | |
| Literatura bazë: | <ul style="list-style-type: none"> - Paçarizi, Rr. <i>Hyrje në Psikolinguistikë</i>, Dukagjini, Prishtinë 2024 - Pinker, Steven, <i>Language instinkt</i>, , Harper Perennial Modern Classics, New York, 1994 - Field, John, <i>Psycholinguistics, The Key Concepts</i>, Routledge, USA, Canada, 2004 | | |

| | |
|----------------------------|--|
| Literatura shitesë: | <ul style="list-style-type: none"> - Cook, Guy, Applied Linguistics, Oxford University Press, 2003 - Gernsbacher, Morton Ann, Lnguage Comprehension as structure building, Lawrence Eblaum Assocites, Hillsdale, 1990 - Gleason, Ratner eds. , Psycholinguistics, second edition, Wadsworth,1998 - Harley Trevor, The Psychology of Language, Psychology Press, 2001 - Pacarizi, Rrahman, Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2011 |
|----------------------------|--|

| Plani i dizajnuar i mësimi: | |
|------------------------------------|--|
| Java | Ligjerata që do të zhvillohet |
| <i>Java e parë:</i> | Të nxënit e gjuhës së parë |
| <i>Java e dytë:</i> | Teoritë mbi të nxënit e gjuhës – bihejviorizmi |
| <i>Java e tretë:</i> | Teoritë mbi të nxënit e gjuhës – nativizmi |
| <i>Java e katërt:</i> | Teoritë mbi të nxënit e gjuhës – kognitivizmi |
| <i>Java e pestë:</i> | Fazat e të nxënit të gjuhës sipas Brown. |
| <i>Java e gjashtë:</i> | Fazat e të nxënit të gjuhës sipas Field. |
| <i>Java e shtatë:</i> | Mosha kritike e të nxënit të gjuhës |
| <i>Java e tetë:</i> | Deprivimi gjuhësor |
| <i>Java e nëntë:</i> | Raporti psikolinguistik ndërmjet gjuhës së lindur dhe standardit gjuhësor |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Bilinguizmi dhe të nxënit e gjuhës së dytë |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Test semestral |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Çrregullimet gjuhësore |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Gabimet e të folurit dhe gabimet e arsyeshme |
| <i>Java e katërmëdhjetë:</i> | Çrregullimet gjuhësore- afazia, hezitimi, belbëzimi, disleksia... <i>Thomas Scovel</i> |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | Rekapitullim i të nxënit të gjuhës |

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të respektojnë normat themelore të sjelljes gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve. Gjatë ushtrimeve studentët janë të obliguar të marrin pjesë aktive në mësim interaktiv. Atyre u mundësohet edhe prezantimi individual dhe grupor dhe qasja interaktive në mësim. Po ashtu studentët kanë mundësi që të kryejnë seminarët e obligueshme nga kjo lëndë.